



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada-Government**

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

*Zyra për Qeverisje të Mirë - Kancelarija za Dobro Upravljanje - Office on Good Governance*

---

# **STRATEGJIA QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE**

**2013 - 2017**

**Prishtinë 2013**

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
Baza Ligjore.....	5
Analizë krahasuese e raporteve të bashkëpunimit Qeveri - Shoqëri Civile me vendet e rajonit ...	6
Përmbledhje e bashkëpunimit të deritanishëm Qeveri – shoqëri civile.....	7
Përfitimet nga Strategjia për bashkëpunim Qeveri – Shoqëri Civile .....	10
Metodologjia dhe procesi i hartimit të Strategjisë .....	11
Fushëveprimi dhe palët.....	14
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	17
Objektivi Strategjik 1: Pjesëmarrje e siguar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit .....	17
Objektivi Strategjik 2: Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile .....	20
Objektivi Strategjik 3: Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje finaciare për OshC .....	22
Objektivi Strategjik 4: Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit.....	225
Mekanizmat përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit dhe raportimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile .....	27

## Përmbledhje ekzekutive

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM), në bashkëpunim të ngushtë me Platformën CiviKos (në tekstin e mëtejme: CIVIKOS), si dhe me përkrahjen dhe bashkëpunimin e Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Planifikim Startegjik pranë Zyrës së Kryeministrit, dhe në vazhdimësi të zbatimit të Ligjit nr.04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare, Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011, si dhe në kërkim të gjetjes së formave të bashkëpunimit, përfshirjes së shoqërisë civile në politikë bërje dhe përkrahjes së organizatave të shoqërisë civile, kanë marrë nismën për hartimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me hartimin e kësaj Strategjie, përkushtohet të:

- njohë dhe vlerësojë rolin dhe punën e shoqërisë civile në ndërtimin e një shoqërie demokratike;
- të krijojë një mjedis përkrahës dhe të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile;
- të vendosë mekanizmat qeveritar që do të mundësojnë një bashkëpunim të strukturuar në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile;
- të përcaktojë qartë obligimet dhe detyrat për secilin institucion qeveritar për këtë bashkëpunim;
- të përcaktojë mekanizmat monitorues për zbatim e kësaj strategjie si dhe
- të inkurajojë shoqërinë civile në zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë brenda sektorit, përfshirë promovimin e një qasje konstruktive e profesionale karshi qytetarëve dhe institucioneve qeveritare.

Objektivat strategjike që synohet të arrihen brenda periudhës 2013-2017 janë:

- **Objektivi Strategjik 1:** Pjesëmarrje e siguar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit;
- **Objektivi Strategjik 2:** Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile;
- **Objektivi Strategjik 3:** Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OshC;
- **Objektivi Strategjik 4:** Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar ky dokument strategjik janë: qeverisja e mirë, transparencja, pjesëmarrja qytetare në politikë bërje dhe llogaridhënia para qytetarëve. Si e tillë, kjo strategji paraqet bazat e bashkëpunimit të Qeverisë me shoqërinë civile në Kosovë, duke e obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës që të angazhohet fuqishëm në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile. Me këtë Strategji do të vendoset një komunikim i rregullt dhe i strukturuar me sektorin e shoqërisë civile, partneritet dhe transparencë në proceset e bërjes së politikave, duke siguruar dhe ruajtur në të njëjtën kohë pavarësinë e sektorit të shoqërisë civile. Gjithashtu, me hartimin e kësaj Strategjie Qeveria e Republikës së Kosovës konfirmon gatishmërinë dhe vullnetin politik për t'i përfshirë qytetarët në vendim - marrje, të përmirësojë shërbimet për qytetarë nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile si dhe ofrojë përkrahje financiare dhe jo-financiare për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile dhe projekteve të propozuara nga ky sektor.

Nevojat kryesore të cilat i adreson kjo Strategji janë:

- nevojën për të siguruar qasje gjithëpërfshirëse dhe mundësi të barabarta për të gjitha organizatat e shoqërisë civile në bashkëpunimin e tyre me Qeverinë, nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe mekanizmave bazë për bashkëpunim;
- nevojën për të bashkëpunuar në mënyrë transparente dhe bazuar në informata të qarta dhe në kohë nga të dyja palët, duke përfshirë edhe hapjen për publikun të të gjitha informacioneve me të cilat disponon Qeveria, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe me ligj;
- nevojën për të bashkëpunuar me sektorin e shoqërisë civile për të zhvilluar politikën, për të promovuar dialogun efektiv duke e përdorë një plan të përshtatshëm për të dyja palët;
- nevojën për të siguruar bashkëpunimin me sektorin e shoqërisë civile në çështjet që janë preokupim i cilësdo pale; dhe
- nevojën për të krijuar një frymë të hapur dhe të partneritetit në mes Qeverisë dhe shoqërisë civile.

Bazë për hartimin e kësaj strategjie janë prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për politika më të mira publike, llogaridhënie e transparencë, besim më të madh të publikut dhe rritje të legjitimitetit.

## Baza Ligjore

Përveç adresimit të nevojave dhe prioriteteve të Qeverisë, kjo Strategji është hartuar duke marrë për bazë dhe në përputhje me një numër të madh të akteve normative të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Më të rëndësishmet nga to janë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës ;
- Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës;
- Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare nr.04/L-57;
- Ligjin për qasje në dokumentet publike nr. 03/L-215;
- Ligji për vetëqeverisjen lokale dhe Rregulloret komunale për transparencë;
- Rregullorja nr. 09/2011 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Udhëzuesi për procesin e konsultimeve publike;
- Kodi i praktikave të mira për pjesëmarrjen qytetare në procesin e vendimmarrjes, i miratuar nga Konferenca e OJQ ndërkombëtare me 1 nëntor 2009;
- Rregullorja nr.03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun
- Udhëzimi administrativ nr.02/2012, për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumentave strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre.

## Analizë krahasuese e raporteve të bashkëpunimit Qeveri - Shoqëri Civile me vendet e rajonit

Forma dhe natyra e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe Qeverisë ndryshon nga vendi në vend dhe nga rrethanat sociale, ekonomike dhe politike në secilin vend veç e veç. Sidoqoftë, situatë në të cilën ndodhet Kosova është e krahasueshme me situatën e vendeve të rajonit ose është e krahasueshme edhe me situatën nëpër të cilën vendet tjera kanë kaluar në kontekst të zhvillimeve të përgjithshme dhe të raporteve shoqëri civile-qeveri.

Në kushte të ndryshimeve dhe zhvillimeve të vazhdueshme demokratike dhe në rrethana të promovimit të formave inovative të qeverisjes, hartimi i politikave të qëndrueshme publike dhe ofrimi i shërbimeve sociale nuk mund të jetë më e drejtë ekskluzive e përfaqësuesve politik. Qeveria ka nevojë për partnerë kompetentë jashtë qeverisë të cilët do ti ndihmonin në krijimin e politikave të efektshme publike dhe në implementimin e intervenimeve efektive për qytetarët e tyre. Në këtë proces, një rol unik mund t'i atribuohet shoqërisë civile, qoftë në iniciimin, organizimin dhe udhëheqjen e debateve gjithëpërfshirëse për të adresuar kërkesat prioritare të qytetarëve apo në ofrimin dhe plotësimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Për të filluar procesin e mirëfilltë të bashkëpunimit, të dy sektoret duhet të njohin vlerat e përbashkëta, të pranojnë përgjegjësitë e përbashkëta rreth çështjeve të caktuara si dhe të shkëmbejnë burimet e tyre financiare dhe njerëzore për realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Ky bashkëpunim do të mbulojë mangësitë e të dy sektoreve por pa i dëmtuar pikat e forta të tyre.

Në shumicën e vendeve të rajonit dhe Europës tashmë janë krijuar mekanizma formal të cilët e rregullojnë rolin e shoqërisë civile si partner të mirëfilltë të qeverisë. Në shumë raste roli i shoqërisë civile qoftë në zhvillimin e demokracisë së brendshme apo në procesin e integritit evropian ka qenë esencial.

Në shumicën e vendeve bashkëpunimi më i theksuar dhe më natyral në mes sektoreve ndodh në mes ministrive specifike dhe OSHC-ve që punojnë në fushat që i mbulon ajo ministri. Normalisht, në këtë rast ekziston interesi i përbashkët i cili për OSHC-të nënkupton sjelljen e ligjeve dhe rregulloreve që reflektojnë kërkesat e anëtarësisë së tyre, ndërsa për ministrinë nënkupton ndihmën që OSHC-të mund të japin në hartimin dhe implementimin e politikave nacionale.

Ndonjëherë ky bashkëpunim udhëhiqet nga një organizëm formal këshillëdhënës i cili përbëhet nga anëtarë të të dy sektoreve, sikurse është p.sh. Këshilli i Qeverisë Sllovaqe për Bashkëpunim me OSHC-të apo Këshilli për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Kroaci i themeluar në vitin 2002 i cili përbëhet nga 10 përfaqësues të qeverisë dhe 14 përfaqësues të shoqërisë civile dhe ka mandatin për të implementuar Planin e Bashkëpunimit në mes sektoreve. Këto Këshilla zakonisht janë karakteristike për format e centralizuara të bashkëpunimit, siç janë marrëveshjet e bashkëpunimit të nivelit qeveritar, por mund të kenë për detyrë edhe mbikqyrjen e implementimit të marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit.

### Përmbledhje e bashkëpunimit të deritanishëm Qeveri – shoqëri civile

Shoqëria civile paraqet një nga shtyllat kryesore të ndërtimit dhe funksionimit të një shoqërie demokratike. Organizatat e shoqërisë civile u ofrojnë qytetarëve një mënyrë alternative të avancimit të interesave të tyre të përbashkëta, kanalizimit të pikëpamjeve të ndryshme dhe sigurimit të interesave të tyre në proceset vendim-marrëse apo edhe përfitimit të shërbimeve të ndryshme.

Edhe pse gjurmë të veprimeve të shoqërisë civile në hapësirën kosovare ekzistojnë qysh para shume dekadash, në kuptimin modern të saj iniciativat dhe organizatat e para të shoqërisë civile në Kosovë datojnë nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta, pas rënies së komunizmit në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe fillimit të një forme të re të shtypjes politike dhe jetës paralele në Kosovë. Këto nisma/organizata kishin karakter kryesisht humanitar (ofrimin e ndihmave humanitare, mbrojtja e të drejtave të njeriut, lëvizjet e ndryshme civile etj), të cilat me kohë morën formën e një rezistence të gjithëmbarshme paqësore ndaj strukturave të asaj kohe.

Përfundimi i luftës, intervenimi i NATO-s, si dhe krijimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në vitin 1999 ka qenë pikë kthese për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë civile në Kosovë. Nevojat shumë të mëdha për ndihmë emergjente dhe rindërtim, nevoja për pajtim ndëretnik, bënë që shoqëria civile të transformojë aktivitetin e saj dhe t'i përshtatet realitetit dhe nevojave të reja, me një përkrahje të madhe financiare dhe teknike nga donatorët ndërkombëtarë.

Në raport me bashkëpunimin në mes të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile në këtë periudhë, vlen të theksohet që për shkak të natyrës së qeverisjes së vendit, përfshirja e qytetarëve dhe e shoqërisë civile në sistemin vendim-marrës të udhëhequr nga UNMIK-u ishte gati se e pamundur. Madje, shpesh herë thuhet që edhe vet IPVQ-të e kishin të vështirë këtë pjesëmarrje, sidomos në periudhën fillestare të administrimit të Kosovës nga Kombet e Bashkuara. Normalisht, nisma të caktuara të shoqërisë civile arritën që të shtyjnë përpara çështje të caktuara, mirëpo pa arritur të formalizojnë bashkëpunimin në mes të dy sektorëve. Nisma e parë zyrtare për formalizimin e bashkëpunimit u ndërmorr vetëm pak kohë para shpalljes së pavarësisë, kur Qeveria e Kosovës dhe Platforma CiviKos nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi në fund të vitit 2007.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova hyri në një periudhë dinamike të zhvillimeve socio-ekonomike dhe politike. Shoqëria civile, duke e përcjellë zhvillimin shoqëror, i 'u përshtat rolit të saj të ri në kuadër të kornizës së përgjithshme të ndërtimit të institucioneve, duke u marrë gjithnjë e më shumë me çështje të qeverisjes dhe politikë-bërjes.

Fillimisht, bashkëpunimi në mes të dy sektorëve u zhvillua në bazë të nismave të ndryshme të dyanshme, mirëpo pa ndonjë organizim dhe strukturë të qëndrueshme. Me avancimin e sistemit të politikë-bërjes nëpërmjet të miratimit të rregullativave të reja ligjore, Qeveria e Republikës së Kosovës vuri në funksion mekanizma të ndryshëm që e mundësonin një bashkëpunim më të strukturuar me shoqërinë civile. P.sh. Rregullorja e Punës e Qeverisë e vitit 2011 obligon të gjitha ministritë që të organizojnë konsultime publike me shoqërinë civile, duke i ofruar kohë të mjaftueshme dhe informata adekuate të gjitha palëve të interesuara. Një problem tjetër i hasur shumë shpesh i cili ende paraqet vështirësi në bashkëpunimin në mes të dy sektorëve është mënyra e përzgjedhjes së organizatave të shoqërisë civile në grupet dhe forumet e ndryshme qeveritare. Përderisa në Kosovë tashmë janë të regjistruara mbi 7,000 OJQ, Qeveria e ka shumë të vështirë të vendosë se cilat organizata duhet të ftohen për të marrë pjesë në grupe të ndryshme punuese për çështje të caktuara.

Në këtë drejtim, përjashtimisht nga çështjet e ngushta sektoriale, fushat kryesore të përgjithshme të cilat janë adresuar si problematike nga shoqëria civile dhe të cilat kanë shtyrë Qeverinë që të miratojë akte të ndryshme normative kanë pasur të bëjnë me qasjen në dokumente dhe informata zyrtare, përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në hartimin e



politikave dhe ligjeve, si dhe ofrimin e shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, çështje problematike është vlerësuar edhe përkrahja financiare e organizatave të shoqërisë civile nga buxheti i Republikës së Kosovës, e cila është ndërmarrë pa ndonjë mekanizëm konkret që do të adresonte specifikat e sektorit civil.

Për më tepër, duke qenë se të dy sektorët kanë një moshë relativisht të re, vazhdimisht është vërejtur mungesa e kapaciteteve të dyanshme për bashkëpunim. Derisa njohja dhe kuptimi i rolit të shoqërisë civile nga shërbyesit civil mbetet i ulët, shoqëria civile vazhdon të ketë njohuri të pamjaftueshme për proceset e politikë-bërjes dhe punës së organeve qeveritare. Këto, si dhe mospajtimet e ndryshme rreth zhvillime të ndryshme në Kosovë, kanë bërë që besimi i ndërsjellë në mes të dy sektorëve të jetë i ulët. Strategjia nuk do të ndikojë në qëndrimet e asnjëres palë për çështjet e caktuara dhe përfundimisht synohet që qëndrimet e secilës palë për çështjet specifike të politikave të materializohen përmes vendimeve, rregulloreve, ligjeve etj. Qeveria e Kosovës e njeh dhe e pranon pavarësinë e organizatave të shoqërisë civile dhe të drejtën e tyre për të mbajtur qëndrime ndryshe dhe për të shprehur ato qëndrime me të gjitha format e lejuara ligjore. Gjithashtu, Qeveria vlerëson potencialin profesional dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në fusha të ndryshme, potencial që i ofron Qeverisë një vlerë të shtuar në hartimin dhe zbatimin e politikave të saj si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Pavarësisht nëse Qeveria dhe organizatat e shoqërisë civile ndërveprojnë në mënyrë bashkëpunuese ose kritikuese e konfrontuese, kjo Strategji synon që ky ndërveprim të jetë formal, transparent dhe të zhvillohet në bazë të rregullave paraprakisht të njohura dhe të barabarta për të gjithë.

## Përfitimet nga Strategjia qeveritare për bashkëpunim shoqërinë civile

Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile i sjell të dyja palëve, por edhe shoqërisë kosovare në përgjithësi një numër të madh përfitimesh. Përfitimet kryesore që parashihen të arrihen mund të grupohen në disa nivele:

Niveli strategjik – Kjo Strategji përcakton objektiva strategjike qartë të definuara të cilat synohet të arrihen brenda një periudhe pesë vjeçare. Si rezultat i një procesi bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës këto objektiva strategjike paraqesin vizionin e përbashkët të shumicës së përfaqësuesëve të të dy sektorëve në raport me çështjet kryesore të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Niveli politik – Me anë të kësaj Strategjie, Qeveria e Republikës së Kosovës e vendos për herë të parë marrëdhënien e saj me shoqërinë civile brenda një kornize institucionale, duke garantuar kështu që bashkëpunimi dhe ndërveprimi në mes të dy sektorëve nuk do të jetë i varur nga vullneti individual i njësive të ndryshme qeveritare, por kornizat dhe mundësitë për bashkëpunim do të jenë të njëjta në vazhdimësi, pavarësisht disponimit momental të përfaqësuesëve të ndryshëm të të dy sektorëve.

Niveli institucional – Kjo Strategji, nëpërmjet masave konkrete të parapara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, ngarkon njësi të caktuara qeveritare me obligime konkrete të cilat duhet të përmbushen brenda afateve të caktuara kohore. Përcaktimi i institucioneve bartëse të veprimeve të ndryshme mundëson që masat e parapara të kenë adresën e caktuar për t'u zbatuar dhe për të kërkuar përgjegjësi. Për më tepër, masat dhe veprimet e veçanta do të ndërmirren në kuadër të një kornize gjithëpërfshirëse, e cila do të koordinohet nga një njësi e vetme qendrore. Kjo do ta evitojë qasjen parciais dhe jo të standardizuar, duke e rritur vlerën e secilit veprim të veçantë në raport me objektivat strategjike në përgjithësi.

Gjithëpërfshirja dhe mundësitë e barabarta – Kjo Strategji, përveç adresimit të problemeve të shumta të deritashme, është ndërtuar duke u bazuar edhe në përvojat e mira të bashkëpunimit në mes të dy sektorëve. Duke i vlerësuar këto përvoja si një model të suksesshëm, kjo Strategji do të mundësojë që bashkëpunimi në mes të dy sektorëve të jetë gjithëpërfshirës nga të dyja palët. Duke i njohur specifikat e sektorëve të veçantë për një bashkëpunim më intenziv ose më pak intenziv, kjo Strategji mundëson që të gjitha organizatat e shoqërisë civile të kenë trajtim

dhe qasje të barabartë ndaj institucioneve qeveritare, të paktën në raport me parimet dhe mekanizmat kryesorë të bashkëpunimit.

Qytetaria aktive – Duke e njohur rolin e organizatave të shoqërisë civile si përfaqësuese të drejtpërdrejta të interesave të grupeve të caktuara të qytetarëve, thellimi i bashkëpunimit të qeverisë me këtë sektor do të kontribuojë në rritjen e përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen e vendit. Sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova në procesin e ndërtimit të shtetit dhe integritit evropian është e pamundur të tejkalohen pa një përfshirje të të gjithë shoqërisë. Kjo Strategji, duke e njohur potencialin e lartë njerëzor që gjendet në sektorin e shoqërisë civile dhe qytetarët individualë, i mundëson Qeverisë të krijojë partnerë jashtë qeverisë të cilët do ti ndihmonin në krijimin e politikave të efektshme publike dhe në zbatimin e intervenimeve efektive për qytetarët e saj.

### Metodologjia dhe procesi i hartimit të Strategjisë

Draftimi i një strategjie të tillë kërkon një qasje metodologjike të përcaktuar qartë, e cila mundëson që përmbajtja e dokumentit të jetë rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, ku të gjithë hisedarët të kenë mundësi të japin kontributin e tyre, por edhe të përcaktojnë rolin dhe të marrin përgjegjësitë e tyre. Duke qenë që vende të ndryshme të rajonit dhe Evropës kanë kaluar nëpër procese të ngjajshme në të kaluarën, grupi nismëtar ka analizuar përvojat e ndryshme dhe ka përcaktuar metodologjinë e këtij procesi në Kosovë.

Qasjet e vendeve tjera kanë qenë të ndryshme varësisht nga specifikat e vendit. Disa vende kanë përgatitur së pari të ashtuquajturat “Marrëveshje të gjëra”, të cilat kanë përcaktuar parimet e bashkëpunimit me të cilat janë pajtuar të dyja palët. Me qëllim të operacionalizimit të këtyre parimeve, si fazë të dytë kanë draftuar “Strategji”, për të mbuluar pjesë të caktuara të marrëveshjes së gjërë, për një afat të caktuar kohor. Megjithatë, për shkak që “Marrëveshja e gjërë” kërkon një kohë më të gjatë për t’u përgatitur dhe palë të qarta nënshkruese (sidomos në raport me shoqërinë civile), shumica e shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore kanë përgatitur drejtpërdrejtë Strategjitë, me të cilat Qeveria njëanshëm ka marrë obligime dhe përgjegjësi për të thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Në këtë drejtim, Kosova ka pasur mundësinë që të ndjekë procesin e plotë, meqënëse paraprakisht një "Marrëveshje e gjërë" është arritur në mes të dy sektorëve (Memorandumi i Bashkëpunimit i Qeverisë së Kosovës me Shoqërinë Civile –përfaqësuar nga Platforma Civikos, nënshkruar me 09/11/2007). Nëpërmjet këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Qeveria dhe përfaqësuesit e një numri të madh të organizatave të shoqërisë civile janë pajtuar për parimet kryesore dhe janë përkushtuar që të zbatojnë një qasje bashkëpunuese në hartimin e Strategjisë. Meqënëse ky Memorandum është vlerësuar që i përmban të gjitha elementet e "Marrëveshjeve të gjëra", nisma e përbashkët për hartimin e kësaj Strategjie është bazuar në parimet e përcaktuara në Memorandum.

Si rrjedhojë, në shtator 2011 me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM/ZQM) është mandatuar si përgjegjëse për hartimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. ZKM/ZQM në bashkëpunim me Zyrën Ligjore dhe Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit kanë themeluar grupin nismëtar për hartim e Strategjisë. Në këtë grup janë përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile të përfaqësuara nga Platforma CiviKos, si dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri civile (KCSF), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) si organizata të shoqërisë civile me përvojë dhe ekspertizë të madhe në zhvillimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimin mes shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Paraprakisht, Platforma CiviKos, në kuadër të një procesi të brendshëm me organizatat anëtare, ka bërë identifikimin e çështjeve kyçe që duhet adresuar në raport me bashkëpunimin me Qeverinë e Kosovës. Bazuar në këtë, grupi nismëtar ka përgatitur metodologjinë e punës dhe ka vendosur për një proces gjithëpërfshirës nga të dyja palët. Vlen të përmendim se i gjithë dokumenti është hartuar në bazë të metodologjisë së përcaktuar me Udhëzimi administrativ nr.02/2012, për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumentave strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, formën, procedurat dhe konsultimin. Prosesi i inicimit por edhe i hartimit ka kaluar nëpër procedurat e përcaktuara me udhëzimin e lartpërmendur si dhe me Rregulloren e Punës duke mos anashkaluar kalimi e dokumentit përmes Zyrës për Planifikim Strategjik për vlerësimin final si dhe përfunimisht Minsitrisë së Financave për përcaktimin e deklaratës financiare .

Çështjet kryesore të cilat kanë dalë të jenë të domosdoshme dhe që do të adresohen përmes Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile janë:

- Sigurimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave si dhe legjislacionit;
- Kontraktimi i shërbimeve publike tek organizatat e shoqërisë civile;
- Përkrahja financiare dhe jo-financiare e organizatave të shoqërisë civile.

Gjithashtu, duke e njohur rolin dhe rëndësinë e punës vullnetare në sektorin e shoqërisë civile dhe më gjërë, vullnetarizmi është konsideruar një çështje që do të duhej të trajtohet në mënyrë horizontale në kuadër të kësaj Strategjie.

Bazuar në përvojat dhe mësimet e nxjerra nga vendet të cilat tashmë e kanë kaluar këtë proces, paralelisht me përfshirjen e gjërë të organizatave të shoqërisë civile, grupi nismëtar e ka vlerësuar të një rëndësie shumë të madhe edhe përfshirjen e duhur të Ministrive dhe agjencive të ndryshme, të cilat do ta kenë barrën kryesore në zbatimin e masave të ndryshme të Strategjisë. Kjo përfshirje është konsideruar e rëndësishme të bëhet qysh në fazat fillestare të draftimit të Strategjisë.

Gjithashtu, për të evituar shndërrimin e Strategjisë në një listë dëshirash të cilat do të ishin vështirë të realizueshme, grupi nismëtar ka insistuar që të gjithë pjesëmarrësit në fazat e ndryshme të draftimit të identifikojnë çështjet më prioritare dhe të përcaktojnë objektiva reale dhe të arritshme. Kjo ka qenë arsyeja që, përkundër nevojave të shumta, kjo Strategji të adresojë në fund vetëm tre objektiva strategjike dhe vullnetarizmin, si një objektive horizontale.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka zgjatur relativisht shumë, mirëpo arsye për këtë ka qenë dhënia e mundësisë për të gjitha palët e interesuara që të kontribuojnë dhe të komentojnë në punën e bërë. Përgjatë më shumë se një viti të punës në hartimin e dokumentit, janë organizuar shumë takime e punëtori me përfaqësues nga organizata të shumta të shoqërisë civile në Kosovë, zyrtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësues të medieve si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Faza e parë ka konsistuar në hartimin e draftit të parë të kornizës logjike të Strategjisë. Një proces i konsultimit publik i ndërmarrë nga ZQM/ZKM dhe Platforma CiviKos në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës ka grumbulluar çështje specifike të cilat pastaj janë shndërruar në objektiva specifike strategjike. Këto objektiva strategjike janë plotësuar me masa të veçanta dhe aktivitete të detajuara të cilat duhet të ndërmerren për t'i përmbushur objektivat strategjike. Në fund, për secilin aktivitet është përcaktuar afati i zbatimit, institucioni përgjegjës, institucionet tjera përkrahëse dhe burimet e nevojshme financiare. Në këtë mënyrë, paralelisht me Strategjinë (e cila është e shtrirë në një afat pesë vjeçar), është hartuar edhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për një periudhë tre vjeçare.

Pas finalizimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, të dyja këto dokumente kanë kaluar edhe njëherë nëpër procesin e konsultimit publik. Gjatë këtij procesi, të gjitha palët e interesuara kanë pasur mundësinë që të japin komentet e tyre me shkrim rreth secilës pjesë të Strategjisë, komente të cilat janë marrë parasysh në hartimin e verzionit përfundimtar të të dyja dokumenteve.

Përkundër këtij procesi gjithëpërfshirës, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë që kjo Strategji, e në veçanti Plani i Veprimit të rishikohen në fund të vitit të dytë, duke mundësuar kështu vlerësimin e arritjeve të deri atëherëshme dhe adresimin e sfidave dhe problemeve të hasura. Ky rishikim është paraparë duke u bazuar në zhvillimet mjaft dinamike në Kosovë, por edhe për shkak të karakteristikave specifike të sektorit të shoqërisë civile, si një sektor i ndryshueshëm dhe në zhvillim të vazhdueshëm.

### **Fushëveprimi dhe palët**

Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile fokusohet në nivel qendror, konkretisht në nivelin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Megjithatë, në përputhje me shtrirjen e kompetencave të Qeverisë, veprimet e ndryshme të parapara në këtë Strategji kanë shtrirje në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Strategjia ka afat 5 vjeçar, duke përfshirë periudhën kohore 2013 – 2017, ndërsa Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë përfshinë periudhën kohore tre vjeçare, respektivisht deri në vitin 2015.

Element shumë i rëndësishëm që ka reflektuar në përcaktimin e objektivave strategjike, masave dhe veprimeve konkrete është periudha kohore të cilën e mbulon kjo Strategji. Periudha e kufizuar kohore ka bërë që pjesëmarrësit në hartimin e Strategjisë të identifikojnë vetëm ato çështje të cilat janë prioritare dhe të arritshme në një afat pesë vjeçar. Përcaktimi i objektivave reale është marrë parasysh sidomos në objektivat strategjike që kanë të bëjnë me shërbimet publike dhe përkrahjen financiare të organizatave të shoqërisë civile. Me anë të këtyre objektivave strategjike synohet që fillimisht të krijohet sistemi i duhur i adresimit të këtyre çështjeve, dhe vetëm më pas të ndërmerren veprimet tjera pasuese që do ta operacionalizojnë sistemin.

Sa i përket fushës së veprimit të mbuluar më Strategji, ajo fokusohet kryesisht në çështjet horizontale që e prekin bashkëpunimin në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile. Gjatë diskutimeve të shumta në fazën e hartimit të kësaj Strategjie, aktorë të ndryshëm kanë ngritur çështje të shumta të cilat kanë të bëjnë me sektorë të caktuar ose probleme specifike të rajoneve të caktuara. Një numër çështjesh të tilla specifike janë përfshirë në kuadër të objektivave strategjike horizontale, ndërsa çështjet tjera të cilat janë lënë jashtë kësaj Strategjie do të mund të adresohen nëpërmjet politikave, marrëveshjeve ose strategjive sektoriale, të cilat do të mund të hartohen në mes të grupeve të veçanta të organizatave të shoqërisë civile dhe digastereve të ndryshme qeveritare. Edhe pse adreson çështje të përgjithshme, kjo Strategji megjithatë përcakton parime të përgjithshme të bashkëpunimit të cilat në të ardhmen duhet të aplikohen edhe në çështjet specifike të sektorëve të caktuar.

Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet që veprimet dhe masat konkrete të parapara me këtë Strategji përfshijnë vetëm ato çështje në të cilat Qeveria ka kompetenca të qarta, siç janë hartimi i politikave dhe ligjeve, përcaktimi i politikave të përgjithshme të ofrimit të shërbimeve publike apo menaxhimi i fondeve të buxhetit të Republikës së Kosovës. Edhe pse është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, kjo Strategji është dokument qeveritar, dhe si i tillë e obligon vetëm Qeverinë e Republikës së Kosovës. P.sh. çështjet e organizimit të brendshëm të organizatave të shoqërisë civile në të cilat Qeveria nuk ka kompetenca, edhe pse shumë të rëndësishme për një bashkëpunim të mirëfilltë, nuk janë përfshirë në kuadër të Strategjisë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë që nga kjo Strategji të përfitojnë vetëm organizatat e shoqërisë civile që përfaqësohen nëpërmjet Platformës CiviKos. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile që kanë interes të ndërveprojnë me Qeverinë e Kosovës janë palë të cilat preken nga kjo Strategji. Gjithashtu, Platforma CiviKos nuk do të synojë të zëvendësojë aktivitetet e organizatave anëtare. Platforma CiviKOs, detyrën kryesore në raport me këtë Strategji e ka nxitjen dhe mirëmbajtjen e mekanizmave të bashkëpunimit, si dhe koordinimin e punës së organizatave anëtare rreth dhënies së kontributit dhe marrjes së përfitimeve nga këto mekanizma. Organizatat anëtare, por edhe të tjerat, do të vazhdojnë të kryejnë punët e tyre bazuar në misionet dhe qëllimet e tyre specifike, por tanimë duke pasur rregulla të qarta të ndërveprimit të tyre me autoritetet publike dhe një mekanizëm të vetin i cili do t'i mbronte dhe do të kujdesej që rregullat po zbatohen. Si e tillë, Platforma CiviKos do të jetë e thirrur që të bëjë koordinimin dhe presionin e duhur ndaj të gjitha palëve që veprimet e kësaj Strategjie do të zbatohen.



## OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

### Objektivi Strategjik 1: Pjesëmarrje e siguruar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit

Demokracia qëndron në pajtueshmërinë e qytetarëve për ushtrimin e pushtetit nga të zgjedhurit e tyre. Për të siguruar këtë pajtueshmëri, demokracia përfaqësuese (model i cili ekziston edhe në Republikën e Kosovës) e bazon vetveten në një grup të rregullave dhe parimeve formale tradicionale – siç janë zgjedhjet dhe fushatat që i shoqërojnë ato. Megjithatë, demokracia përfaqësuese bazohet edhe në ndër-veprime të vazhdueshme në mes të autoriteteve publike dhe qytetarëve në periudhën ndërmjet zgjedhjeve.

Bazuar në Kushtetutë, Kuvendi është institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës, i cili ka kompetencën të miratojë ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme. Megjithatë, bazuar në mandatin e saj kushtetues, shumica dërmuese e ligjeve dhe akteve tjera propozohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila poashtu ka kompetenca ekzekutive në zbatimin e këtyre akteve. Duke qenë që politikat dhe ligjet që propozohen dhe zbatohen nga Qeveria kanë një rëndësi të jashtëzakonshme në rregullimin e jetës shoqërore, ekonomike dhe politike të shoqërisë kosovare, fuqizimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit është objektivi i parë i kësaj Strategjie.

Në dekadën e fundit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një përvojë domethënëse në politikë-bërje, ndërsa viteve të fundit kujdes i posaqëm i është kushtuar përfshirjes së qytetarëve në përgjithësi dhe organizatave të shoqërisë civile në veçanti në këtë proces. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 25.08.2011 ka miratuar Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Vendimi nr. 04/34). Me këtë Rregullore përcaktohet: mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës; rregullat dhe procedurat për hartimin e legjislacionit dhe rekomandimeve të politikave nga Qeveria dhe ministritë, si dhe organizimi i mbledhjeve të Qeverisë dhe puna e Komisioneve Ministrore. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, për herë të parë Qeveria ka obliguar të gjitha institucionet në varësi të saj që për të gjitha politikat, ligjet dhe aktet tjera të rëndësishme të “publikojnë përmbajtjen e propozimit të tyre për komente nga publiku dhe në mënyrë specifike do të kërkojnë komente nga organizatat jo-qeveritare të cilat

ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga propozimi". Gjithashtu, nga organet propozuese kërkohet që të "ofrojnë informata të mjaftueshme në një formë të kuptueshme nga publiku për t'i mundësuar publikut që të kuptojë natyrën dhe pasojat e propozimit, si dhe të shpallin publikisht fillimin e procesit të konsultimit dhe do të lejojnë kohë të mjaftueshme për publikun dhe organizatat jo-qeveritare që të shqyrtojnë rekomandimet dhe të japin përgjigjet e tyre të mirëfillta". Për më tepër, "rezultatet e procesit të konsultimit do të raportohen në mbledhjen e Qeverisë ose në mbledhjen e Komisionit Ministror dhe do jenë pjesë përbërëse e koncept dokumentit ose memorandumit shpjegues". Bazuar në këtë rregullore, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me datë 29/09/2011 ka nxjerr një Udhëzues për procesin e konsultimeve publike, me qëllim që t'u ndihmohet nëpunësve civilë dhe organizatave të shoqërisë civile për të planifikuar dhe zbatuar me sukses një proces të konsultimeve publike, për të përcaktuar qartë pritjet nga njëri-tjetri si dhe për të evituar keqkuptimet që mund të lindin në rastet kur institucione apo organizata të ndryshme marrin nisma apo kontribuojnë në mënyra tërësisht të ndryshme.

Gjithashtu, me datë 05.04.2011 është nxjerr edhe Rregullorja Nr.03/2011 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun. Me këtë rregullore përcaktohet themelimi dhe funksionimi i një sistemi koherent dhe të koordinuar për të komunikuar me publikun politikat dhe aktivitetet nga ana e institucioneve publike. Kjo Rregullore përcakton rolet, detyrat dhe funksionet e zyrave dhe zyrtarëve përkatës të komunikimit dhe zëdhënësve në institucionet publike. Gjithashtu kjo rregullore përcaktohen rregullat për komunikimin e përgjithshëm të politikave dhe të aktiviteve qeveritare për publikun.

Edhe pse ky avancim i kornizës ligjore ka ngritur në mënyrë të ndjeshme nismat e dyanshme për të bashkëpunuar në kuadër të hartimit të politikave dhe ligjeve, megjithatë, mund të konstatohet që ende nuk është zhvilluar një kulturë e përgjithshme e konsultimit, ashtu siç nuk janë zhvilluar sa duhet kapacitetet e nevojshme për zbatimin e teknikave të ndryshme për përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në këtë proces. Për më tepër, ende nuk ka ndonjë formë të strukturuar dhe të standardizuar të kësaj pjesëmarrjeje. Edhe pse gjatë vitit 2012 është vërjetur një zbatim në rritje i mënyrave të konsultimit publik të përcaktuara me Rregullore dhe Udhëzues, dikastere të ndryshme qeveritare ende vazhdojnë të kenë nivele, forma dhe mekanizma të ndryshëm të përfshirjes së shoqërisë civile në vendim-marrje, ndërsa organizatat e ndryshme i përgjigjen këtyre iniciativave në mënyrat nga më të ndryshme. E fundit, pavarësisht përfshirjes së procesit të konsultimit publik në sistemin e përgjithshëm qeveritar të

raportimit dhe monitorimit, zbatimi i suksesshëm i mekanizmave të krijuar kërkon një sistem të veçantë i cili do të koordinojë dhe mbikqyrë aspektet e ndryshme të përfshirjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Masat e planifikuara për realizimin e kësaj objektive janë:

- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.1. Hartimi / plotësim-ndryshimi i legjislacionit bazë/referues për përfshirje të OShC në hartim dhe zbatim të politikave
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.2. Përcaktimi i standardeve të përfshirjes së OShC në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.3. Ngritja e kapaciteteve profesionale të nëpunësve civil dhe pjesëtarëve të OShC në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.4. Ndërtimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe i raportimit për përfshirje të OshC

## Objektivi Strategjik 2: Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile

Shoqëria civile është duke realizuar një spektër të gjërë të shërbimeve sociale dhe aktiviteteve në përkrahje të komunitetit të cilat më herët janë përmbushur nga shteti. Në shoqëritë moderne kërkesa për shërbime të reja sociale është vazhdimisht në rritje dhe komuniteti është vazhdimisht në kërkim të diversitetit të këtyre shërbimeve. Qeveritë tashmë u janë kthyer proceseve të vendosura nga komunitet në mënyrë që të adresojnë problemet lokale me zgjidhje lokale.

Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë tashmë ka kohë që ofrojnë një numër të konsiderueshëm të shërbimeve sociale për grupe të ndryshme përfituesish. Derisa menjëherë pas përfundimit të luftës së vitit 1999 ishin kryesisht organizatat ndërkombëtare ato të cilat ofronin shërbimet e nevojshme sociale për qytetarë, tashmë gjithnjë e më shumë organizata vendore janë duke e bërë një gjë të tillë. Shembuj nga fusha të ndryshme siç janë shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, strehimoret e viktimave të dhunës apo personave të trafikuar, etj dëshmojnë që organizatat e shoqërisë civile në Kosovë mund të jenë pjesëmarrës të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale. Këto shërbime shtrihen qoftë në plotësimin e atyre që ofrohen nga shteti (p.sh. shëndetësia, mirëqenja sociale) apo në ofrimin e shërbimeve të cilat momentalisht nuk po mund të ofrohen nga shteti.

Megjithatë, në fusha të ndryshme në kuadër të të cilave ofrohen këto shërbime zbatohen parime të ndryshme të delegimit të përgjegjësive për të ofruar shërbime të caktuara. Mënyra e licensimit apo financimit të shërbimeve të caktuara jo gjithmonë është e rregulluar si duhet, dhe kjo shpesh herë paraqet pengesa për palët kontraktuese, e sidomos vështirësi në pranimin e shërbimeve cilësore nga përfituesit e këtyre shërbimeve.

Në vende të ndryshme të Europës dhe më gjërë aplikohen modele të ndryshme të delegimit të shërbimeve të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile. Modeli gjerman i përkrahjes favorizon komunitetin i cili ballafaqohet me një problem që të adresojë dhe zgjidh vetë atë problem; Modeli normativ hungarez përcakton që secili entitet që ofron shërbime të cilat janë detyrë e shtetit (përfshirë këtu edhe edukimin, shëndetësinë, dhe shërbimet e mirëqenies sociale) dhe i cili përmbush kriteret e përcaktuara nga shteti duhet të financohet nga qeveria bazuar në

numrin e klientëve që i shërben; Sistemi i konkurrencës i Britanisë së Madhe dhe Polonisë paraqet modelin sipas të cilit sa herë që qeveria dëshiron të ofrojë një shërbim që është i renditur në “Listën e aktiviteteve për përfitim të komunitetit” ajo shpall tender të hapur për të gjitha entitetet. OSHC-të duhet sipas këtij modeli të konkurrojnë me entitetet tjera (institucionet shtetërore apo kompanitë private) për të fituar kontratën në bazë të shërbimeve më të mira dhe më të lira të ofruara.

Në Kosovë ende nuk është zhvilluar një debat i mirëfilltë rreth parimeve dhe modelit në bazë të së cilave organizatat e shoqërisë civile do të ofronin shërbime të cilat janë obligim i shtetit. Pikërisht përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe modelit është qëllimi kryesor i kësaj objektivë strategjike, për t’u pasuar me kompletimin e kornizës ligjore të nevojshme dhe ndërtimin e mekanizmit të nevojshëm të mbikqyrjes. Meqenëse shtrirja e shërbimeve potenciale që mund të ofrohen nga shoqëria civile është shumë e gjërë, dhe varësisht nga fusha specifike aplikohen edhe rregulla specifike, ministritë dhe organizatat që mbulojnë sektorë të caktuar do të inkurajohen që të zhvillojnë mekanizmat e tyre specifike, mirëpo gjithënjë duke u bazuar në parimet e përgjithshme të përcaktuara paraprakisht.

Në këtë kontekst, shoqëria kosovare mund të përfitojë shumë nga shërbimet që mund të ofroheshin nga shoqëria civile përmes zhvillimit të asaj që sot në botë njihet si ekonomia sociale e që në fakt paraqet aktivitet ekonomik jofitimprurës që mund të përmirësoj kushtet ekonomike, sociale dhe ambientale të komunitetit. Ekonomia sociale mund të jetë burim vital i vendeve të reja të punës, i njohurive dhe aftësive të reja që hapin shtigje të reja punësimi. OSHC-të mund të jenë burim i njohurive sipërmarrëse në fushat ku ekonomia e tregut dështon të ofrojë shërbime efikase.

Masat e planifikuara për realizimin e kësaj objektivë janë:

- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.1. Hartimi i kornizës ligjore që rregullon procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike nga OShC dhe që përcakton fushat e kontraktimit
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.2. Përcaktimi i standardeve dhe parimeve për kontraktim të shërbimeve publike nga OshC
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.3. Ndërtimi i mekanizmit të përbashkët i mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve për licencim dhe ofrim të shërbimeve.

### Objektivi Strategjik 3: Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OshC

Edhe pse një pjesë e rëndësishme e punës së sektorit të shoqërisë civile bëhet në mënyrë vullnetare, për aktivitete më specifike nevojiten fonde të veçanta që mundësojnë ofrimin e shërbimeve, ekspertizës apo infrastrukturës së domosdoshme për aktivitetet e caktuara. Duke mos pasur të ardhura të vazhdueshme nga një burim i vetëm, karakteristikë e veçantë e sektorit civil është nevoja për ngritje të vazhdueshme të fondeve dhe përdorimi i tyre për të zbatuar misionin e organizatës.

Prej vitit 1999, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kanë pasur një përkrahje financiare të fuqishme nga donatorët ndërkombëtarë, gjë që ka bërë që përveç numrit të madh të OJQ-ve të regjistruara, fondet nëpërmjet të cilave ato kanë funksionuar kanë qenë mjaft lehtë të arritshme. Ky “vërshim” i donatorëve ka pasur të mirat dhe të këqijat e veta. Një numër i organizatave të shoqërisë civile kanë arritur që të ngrisin kapacitetet e tyre njerëzore dhe financiare dhe të shndërrohen në përfaqësuese legjitime të anëtarësisë së tyre ose qendra të qëndrueshme profesionale të fushave të ndryshme. Në anën tjetër, një pjesë e madhe e sektorit mbetet shumë e varur nga financimi ndërkombëtar dhe aktivizohet vetëm kur ka fonde në dispozicion. Të dhënat e vitit 2011 tregojnë që afër 80% të fondeve për shoqërinë civile vijnë nga donatorët ndërkombëtarë, duke dëshmuar kështu për një varësi të madhe ndaj donatorëve të huaj. Përderisa roli i donatorëve të huaj në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile është i pazëvendësueshëm, sidomos duke ditur vështirësitë ekonomike nëpër të cilat ka kaluar Kosova menjëherë pas përfundimit të luftës dhe fazës së tranzicionit, largimi i pritshëm i një numri të madh donatorësh e rrezikon seriozisht funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit.

Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile kanë filluar tashmë të kërkojnë seriozisht burimet alternative të financimit, e që kryesisht pritet të jenë vendore. Si menaxhuese kryesore e buxhetit të Republikës së Kosovës, Qeveria mund të marrë një rol shumë të rëndësishëm në këtë aspekt. Edhe në të kaluarën fondet shtetërore për organizatat e shoqërisë civile nuk kanë munguar. Llogaritet që rreth 8% të fondeve për shoqërinë civile kanë ardhur nga buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa statistika të sakta për fondet për shoqëri civile nga niveli qeveritar nuk ka. Në pothuajse të gjitha vendet e Europës, financimi nga mekanizma të ndryshëm të qeverisë paraqet një përqindje të konsiderueshme të financimit të përgjithshëm të

OSHC-ve. Në vitin 2003, përqindja e financimit të OSHC-ve nga fonde qeveritare sillet nga 30% në Suedi e Norvegji deri në 70% në Irlandë dhe Belgjikë, ndërsa në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore nga 20% në Sllovaki deri në 40% në Republikën Çeke.

Megjithatë, aktualisht shqetësuese mbeten disa aspekte të rëndësishme në lidhje me mënyrën e dhënies së fondeve, e të cilat kanë të bëjnë me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së organizatave përfituese, mekanizmat e raportimit dhe mbikqyrjes si dhe më e rëndësishmja, mekanizmat që do të siguronin ruajtjen e pavarësisë së veprimit të organizatave të shoqërisë civile që përfitojnë fonde qeveritare. Korniza aktuale ligjore që e përcakton shpenzimin e parasë publike nuk i adreson sa duhet specifikat e financimit të sektorit të shoqërisë civile, duke krijuar kështu pengesa serioze në shfrytëzimin e potencialit të shoqërisë civile në zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme qeveritare, por edhe në vet zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi.

Për këtë arsye, është me rëndësi që qeveria të ofrojë mbështetje financiare për sektorin civil, por këtë mbështetje financiare ta bëjë në kuadër të një sistemi transparent, me kriteret të paracaktuara dhe mekanizma të qartë të raportimit dhe mbikqyrjes. Gjithashtu, duke qenë që një numër i konsiderueshëm i organizatave të shoqërisë civile kanë për mision avancimin e interesit publik, duhet të konsiderohen edhe burimet tjera të financimit publik përveç buxhetit të Republikës së Kosovës. Për shembull, vende të shumta aplikojnë modelin e “fondeve të llotarisë” ose “orientimin e drejtpërdrejtë të përqindjes së caktuar të tatimeve” për të krijuar fonde për zhvillimin e shoqërisë civile. Të gjitha këto elemente duhet të trajtohen duke i analizuar specifikat e Kosovës dhe duke ndërtuar një sistem të tillë që do ta rriste efektivitetin e fondeve publike të shpenzuara, por njëkohësisht ta ruante pavarësinë e veprimit të organizatave të shoqërisë civile që pranojnë fonde nga Qeveria.

Aspekt tjetër më rëndësi është Statusi për Përfitim Publik, i cili në Kosovë ekziston qysh nga viti 1999, por viteve të fundit është ballafaquar me probleme të shumta të harmonizimit në mes të ligjeve të ndryshme dhe zbatimit në praktikë. Harmonizimi i obligimeve dhe përfitimeve për organizatat që e gëzojnë këtë status do të avanconte punën e organizatave për përfitim publik, duke kontribuar kështu drejtpërdrejtë në adresimin e çështjeve të ndryshme nga të cilat përfitojnë grupet e marginalizuara ose shoqëria kosovare në përgjithësi. Paralelisht me këtë,

problematike paraqitet edhe inkurajimi i donacioneve private dhe filantropisë, të cilat mund të paraqesin një burim mjaft interesant për shoqërinë civile. Lehtësirat tatimore për donatorët privatë dhe kompanitë duhet të rregullohen qartë në kuadër të sistemit fiskal të Republikës së Kosovës, duke krijuar një mjedis inkurajues për filantropi dhe sponsorizim.

Viteve të fundit, proporcioni i fondeve të Bashkimit European për shoqërinë civile është në rritje të vazhdueshme, dhe kjo pritet të rritet edhe më tej. Megjithatë, procedurat e Bashkimit European kërkojnë që një pjesë e fondeve të bashkëfinancohen nga organizatat përfituese, duke e bërë kështu absorbimin e fondeve të BE-së mjaft të vështirë për organizatat kosovare. Bashkëfinancimi i fondeve të BE-së për shoqëri civile është njëra nga çështjet të cilat adresohen me këtë Strategji, së bashku me përfshirjen e shoqërisë civile në mekanizmat qeveritarë të koordinimit të donatorëve.

E fundit, për organizatat e shoqërisë civile ndihmesë mjaft e madhe është edhe përkrahja jo-financiare, respektivisht vënia në dispozicion të organizatave dhe aktiviteteve të tyre të resurseve të ndryshme të cilat janë në posedim të autoriteteve publike. Përderisa pjesa më e madhe e kësaj përkrahjeje në praktikë ofrohet nga niveli komunal, kjo Strategji synon që të përcaktojë parimet e përgjithshme në kuadër të cilave autoritetet publike të niveleve të ndryshme do t'i përkrahnin nismat e ndryshme civile.

Masat e planifikuara për realizimin e kësaj objektivje janë:

- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.1. Reformimi i legjislacionit për zbatim të përbashkët të projekteve
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.2. Krijimi i mjedisit inkurajues për filantropi dhe sponsorizim
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.3. Standardizimi i statusit për përfitim publik
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.4. Përfshirja e shoqërisë civile në mekanizmat për koordinim me donatorët
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.5. Përcaktimi i kritereve për dhënie dhe zbatimin e granteve nga fondet publike
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.6. Përcaktimi i kritereve për përkrahjen jo-financiare për OShC



## Objektivi Strategjik 4: Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit

Në përgjithësi dhe parimisht vullnetarizmi është praktika e punës së njerëzve, të cilët punojnë për të tjerët pa qenë të motivuar nga përfitimet financiare apo materiale. Vullnetarizmi kryesisht lidhet me një veprimtari altruiste, që ka për qëllim promovimin e cilësisë më të lartë jetësore për njerëzit. Njerëzit poashtu marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare për të përfituar shkathtësi të reja pa patur nevojën e investimeve financiare të punëdhënësit. Vullnetarizmi mund të ketë forma të ndryshme dhe ushtrohet nga grupe të ndryshme njerëzish. Shumë vullnetarë janë të trajnuar në veçanti mbi fushën ku veprojnë, si psh. në mjekësi, arsim apo shpëtim emergjent. Të tjerët marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare në bazë të nevojës dhe kërkesës, si psh. duke reaguar ndaj një katastrofe natyrore. Si i tillë, vullnetarizmi është një ndër elementet kryesorë të shoqërisë civile.

Janë dy përfitime të mëdha që sjell vullnetarizmi. Së pari, përfitimi ekonomik, pasi që vullnetarizmi paraqet një ndihmë të rëndësishme ekonomike për shoqërinë. Aktivitetet që realizohen nga vullnetarët, në rastin e kundërt do të duhej të financoheshin nga shteti ose kapitali privat. Vullnetarizmi krijon vlerë të shtuar në bilancin e përgjithshëm ekonomik të një shteti dhe redukton shpenzimin qeveritar. Por, vullnetarizmi ka edhe një dimension të dytë, ndoshta më të rëndësishëm në kuptim të efekteve pozitive. Ai ndihmon në krijimin e komuniteteve të forta dhe të bashkuara. Vullnetarizmi rrit nivelin e besimit mes njerëzve dhe ndihmon zhvillimin e normave të solidaritetit dhe reciprocitetit, të cilat janë qenësore për komunitete stabile. Për më tepër, duke ndihmuar në ndërtimit e këtij “kapitali social”, vullnetarizmi luan rol të rëndësishëm në rigjenerimin ekonomik.

Promovimi dhe aplikimi i punës vullnetare është veprim i koordinuar i sektorëve relevantë të një shoqërie, ku shteti, shoqëria civile, bizneset dhe familja janë në bërthamën e tij. Kosova ka një periudhë të ndritshme të mobilizimit shoqëror (solidariteti dhe vullnetarizmi) gjatë viteve të 90-a. Kjo praktikë nuk është treguar e qëndrueshme edhe në vitet e pas-luftës. Shkaqet themelore të kësaj mospërputhje janë: konteksti i ri politik dhe shoqëror, besimi se shteti duhet të jetë përgjegjës i vetëm për mirëqenien shoqërore, mungesa e politikave dhe legjislacionit adekuat, deri te aplikimi agresiv i parimeve të tregut të lirë në një ekonomi post-konflikti. Ky degradim i punës vullnetare ka ndikuar në dëmtimin e substancës së kapitalit shoqëror të qytetarëve të Kosovës.

Vullnetarizmi aktualisht është një fushë e nën-rregulluar në legjislacionin dhe politikat shtetërore të Kosovës. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë trajton në mënyrë të përgjithshme vullnetarizmin tek të rinjtë, ndërsa atë e përkufizon si “veprimtari e rinisë e organizuar nga Institucioni përkatës, ku të rinjtë vullnetarisht ofrojnë kohën, punën, njohuritë, aftësitë e tyre pa pagesë apo shpërblim, në shërbim të komunitetit, për të mirën e shoqërisë”. Ky ligj kufizohet në trajtimin e vullnetarizmit vetëm në moshën 15 - 24 vjeç, duke e lënë të patrajtuar pjesën tjetër të shoqërisë e cila ka një potencial të madh të punës vullnetare. Për më tepër, kufizimi në vetëm disa sektorë të caktuar e bën qasjen e përgjithshme institucionale ndaj vullnetarizmit të fragmentuar dhe të pamjaftueshme për të zhvilluar punën vullnetare në mbarë shoqërinë kosovare.

Marrë parasysh diversitetin e vullnetarizmit, është pothuaj e pamundur që të sugjerohen modele universale për zhvillimin e tij përmes ligjeve dhe politikave, pa e trajtuar këtë çështje nëpërmjet një debati gjithëpërfshirës dhe të bazuar në informata dhe analiza të detajuara. Çka funksionin në një shtet, mund të jetë kundërproduktive në një shtet tjetër, me kulturë dhe tradita të ndryshme. Vullnetarizmi është produkt i mjedisit ku ai zhvillohet dhe politika qeveritare për promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit në një vend mund të jetë e papërshtatshme për vendin tjetër.

Për këtë arsye, kjo Strategji synon që fillimisht të analizohet dhe të identifikohen nevojat dhe profili i punës vullnetare në Kosovë, dhe varësisht nga kjo të zhvillohet debati dhe ndërtohet sistemi më adekuat për nevojat specifike të Kosovës. Parimet që do të përcaktohen nga politikat dhe legjislacioni pasues do të synojnë që të ndërtojnë një sistem të integruar të vullnetarizmit, duke përfshirë kështu fusha dhe institucione të ndryshme të cilat kanë potencialin e nevojshëm për zhvillimin e vullnetarizmit.

Masat e planifikuara për realizimin e kësaj objektive janë:

- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.1. Identifikimi i nevojave dhe profilit të vullnetarizmit në Kosovë
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.2. Përcaktimi i parimeve të sistemit për një qasje të integruar në zhvillimin e vullnetarizmit
- Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.3. Ndërtimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe i raportimit për vullnetarizëm

## Mekanizmat përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit dhe raportimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

Krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë si dhe forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit në mes tyre do të thotë edhe partneritet në baza të barabarta dhe të vullnetit të mirë. Bazuar në këtë Strategji, Qeveria duhet të zhvillojë instrumente dhe struktura të cilat do të përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë specifike të secilës palë në kuadrin e partneritetit të tyre dhe njëherit të krijojnë mekanizma raportimi dhe monitorimi e që do të përcjellë zbatimin e detyrave specifike që dalin nga kjo Strategji.

Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë, me ndihmën e CiviKos do të jetë përgjegjëse për koordinimin e gjithë procesit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, ndërsa për të siguruar një qasje të pavarur në mbikqyrjen dhe vlerësimin e suksesit të zbatimit të kësaj Strategjie do të themelohen një Këshill i përbashkët me pjesëmarrjen e të dyja palëve. Mandati i këtij Këshilli do të përfshijë gjithashtu edhe diskutimin dhe propozimin e zgjidhjeve për çështjet tjera që nuk janë pjesë e kësaj Strategjie, por që ndikojnë në bashkëpunimin e të dyja palëve dhe që janë preokupim i cilësdo palë. Këshilli do të bashkëkryesohet nga përfaqësues të Platformës CiviKos dhe përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa ZQM do të shërbejë si Sekretarit dhe do të jetë organi përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Me qëllim të themelimit, organizimit, kryerjes efikase dhe të ligjshme të përgjegjësive të këtij Këshilli, menjëherë pas aprovimit të kësaj Strategjie, ZKM/ZQM bashkë me Platformën CiviKos do të përgatisin një rregullore të veçantë me të cilën do të përcaktohen rregullat e punës, organizimi, fushëveprimi, funksionet e këtij këshilli si dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve.

Gjithashtu, ZKM/ZQM bashkë me Platformën CiviKos dhe në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat tjera të interesuara do të organizojnë fushata promovuese me qëllim që të gjitha institucionet dhe shoqëria civile të jenë të informuar për aprovimin e kësaj Strategjie dhe obligimet dhe përfitimet që rrjedhin nga kjo Strategji.

ZKM/ZQM obligohet që në baza vjetore të publikoj Raportin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, ndërsa Platforma CiviKos dhe organizatat tjera të interesuara do të jenë të ftuara që në baza të rregullta të monitorojnë dhe raportojnë paralelisht rreth zbatimit të aktiviteteve konkrete të parapara me këtë Strategji. Bazuar në monitorimin dhe raportet e të dyja palëve, Këshilli do të autorizohet që të bëjë vlerësimin dhe rishikimin e Strategjisë pas një periudhe dy vjeçare.